

FORMULAR I SIGURIMIT TE MAKINERIVE

DEGA	Zyra qendrore Tirane	Polica Nr.		Data e shitjes	
-------------	---------------------------------	-------------------	--	---------------------------	--

1.Të dhënat për te Siguruarin

I siguruari	
Adresa	Tirane

2.Të dhënat për te Objektin e siguruar

Objekti	
Adresa	

3. Periudha e Sigurimit

Nga data (ora 00:00)		Deri date (ora 00:00)		Data e sotme ora	
---------------------------------	--	----------------------------------	--	-----------------------------	--

4. Primi i sigurimit:

Primi vjetor	Euro	Taksa e primit	Euro	Primi total	Euro
---------------------	-------------	-----------------------	-------------	--------------------	-------------

Bashkelidhur dhe pjese perberese e kesaj police jane:

- Lista e Makinerive dhe pyetesori plotesuar nga Klienti, si dhe Kushtet e Pergjithshme te sigurimit te makinerive.

Specifikime te Makinerise dhe impiantit te siguruar:

Nr. I artik	Modeli makinerise	Nr serial	Pjesa e zbritshme	Shuma e sigurimit (Euro)
1	Sipas Listes Bashkengjitur	Sipas Listes Bashkengjitur	10% e dëmit, min. 10,000 Euro	
Totali				

SIGURUESI:

INTERSIG Vienna Insurance Group Sh.a.

I SIGURUARI:

Polica e sigurimit të Makinerive me nr. Serie _____

Ndërkohë që i siguruari i emërtuar në Policë i ka bërë kompanisë **Intersig VIG** (që këtej e tutje i quajtur "Siguruesi") një propozim me shkrim duke plotësuar një pyetësor i cili, së bashku me deklaratat e tjera të bëra me shkrim nga i Siguruari për qëllimet e kësaj Police, mendohet se është përfshirë në këtë dokument.

Tani kjo Policë Sigurimi provon që, me kusht që Siguruari, i ka paguar Siguruesit primin e përmendur në Policë dhe subjekt i termave, përjashtimeve, dispozitave dhe kushteve të përfshira këtu apo të vërtetuara me anë të kësaj,

Siguruesi me anë të kësaj bie dakort me të Siguarin, që nëse në çfarëdo kohe gjatë periudhës së sigurimit të deklaruar në Policë apo gjatë çdo periudhe tjetër pasuese për të cilën I Siguruari paguan dhe Siguruesi mund ta pranojë premin për rinovimin e kësaj police, njësitë (ose çdo pjesë e tyre) të përfshira në këtë Police, dhe në vendin e përmendur në të, ndodh një humbje apo dëm fizik i paparashikuar apo i papritur apo dëm nga shkaqe të tilla si defekte në ndërtim apo material, dizenjimin i gabuar, gabime në laborator apo në konstruksion, puna e keqe, mungesa e aftësive, pakujdesia, mungesa e ujit në bolierë, shpërthimi fizik, copëtimi nga forca centrifugale, qarku i shkurtër, stuhia apo çdo shkak tjetër që është përjashtuar në mënyrë specifike, që në një farë mënyre ka nevojë për riparim apo zëvendësim.

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguarin përse i përket një humbjeje apo dëmi të tillë, siç është parashikuar që këtu e tutje, me pagesë apo para në dorë (cash), zëvendësim apo riparim (sic është rene dakort me Siguruesin) deri në një shumë që nuk kalon shumen e sigurimit të secilës nga njësitë e specifikuar në kete police dhe që nuk kalon në tërësi shumën totale të shënuar në listë për të cilën është siguruar.

Kjo Policë do të zbatohet për njësitë e siguruaras pas përfundimit me sukses të testeve të pranimit të performancës së tyre kur ato janë në proces pune apo jo, apo që po çmontohen për qëllime pastrimi apo kontrolli të përgjithshëm, ose gjatë operacioneve të përmendura më sipër, ose kur po ndërrohen brenda vendit të punës, ose gjatë ri-konstruksionit.

Përjashtimet:

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për:

1. Pjesën e Zbritshme të deklaruar në Police, e cila do të mbulohet nga i siguruari për çdo ngjarje; nëse më shumë se një njësi humbet apo dëmtohet gjatë një ngjarjeje, I siguruari, sidoqoftë, nuk do t'i kërkojë të mbulojë më shumë se shumën e vetme më të lartë që aplikohet për artikuj të tillë;
2. humbjen apo dëmtimin e mjeteve të këmbimit si psh vulat, modelet, cilindrat e gdhendur, pjesët të cilat me anë të përdorimit të tyre dhe/ose natyrës kanë një shkallë të lartë të konsumimit ose zhvlerësimit, psh veshje të brendshme zjarrruduese, çekanë shkatërrues, objekte xhami, rripa, litarë, tela, goma, media operative psh lubrifikantë, karburantë, katalizatorë;
3. humbja apo dëmtimi për shkak të zjarrit, vetëtimës direkte, shpërthimit kimik (përveç shpërthimeve të gazit në boliera), fikja e një zjarri apo shkatërrimi pasues, avionë apo pajisje të tjera ajrore apo artikuj të hedhur nga ato, vjedhje apo grabitje apo përpjekje për të bërë një gjë të tillë, shembje e ndërtesave, vërshim uji, përmbytje, tërmet, fundosje, rrëshqitje dheu, ortek, stuhi, ciklon, shpërthim vullkanik apo katastrofa natyrore të tjera të ngjashme me këto;
4. humbje apo dëmtim për të cilin një furnitor, kontraktor apo riparues është i përgjegjës sipas ligjit dhe/ose sipas kontates.
5. humbje apo dëmtim i shkaktuar nga ndonjë gabim apo defekt që ka ekzistuar në kohën e fillimit të kësaj Police, gjë e cila është ditur nga I siguruari apo përfaqësuesit e tij, nëse gabime apo defekte të tilla janë bërë të ditur Siguruesit apo jo;

6. humbje apo dëmtim që vijnë si rezultat i një veprimi të vullnetshëm apo neglizhence madhore nga ana e të Siguruarit apo përfaqësuesve të tij;
7. çdo pasojë e luftës, pushtimit, akteve të armiqve të jashtëm, armiqësive (qoftë kjo luftë e deklaruar ose jo), luftë civile, rebelim, revolucion, kryengritje, rebelim, shkatërrim, grevë, mbyllje e fabrikës, rebelim civil, ushtarak apo fuqi uzurpuese, akte të një grupi apo personave keqdashës apo persona që veprojnë në emër apo në lidhje me organizata politike, bashkëpunime kriminale, konfiskime, sekuestrime, rekuizim apo shkatërrim apo dëm i pronës me urdhër të qeverisë de jure ose de facto nga një autoritet publik;
8. çdo pasojë e shpërthimeve bërthamore, rrezatimit bërthamor apo ndotjes radioaktive;
9. humbje apo dëmtim që vijnë nga pasoja direkte të ndikimit të vazhdueshëm të operacionit (psh nga përdorimi, amortizmi, kaviteti, erozioni, gërryerja, ndryshku, smërçi i bolieri);
10. humbja pasuese apo detyrimet e çfarëdo lloji apo përkrahje, çdo lloj pagese mbi shumën e dëmshpërbleshme për dëme materiale siç parashikohet këtu. Në çfarëdo rrethane, gjyqesore apo procedime të tjera ku Siguruesit pretendojnë që, për shkak të dispozitës së Përfshirimit 7, çdo humbje apo dëmtim nuk mbulohet nga kjo Policë, detyrimi për të provuar nëse një dëm apo humbje e tillë do të mbulohet do të jetë përgjegjësi e të Siguruarit.
11. Dëmtimet gjate zhvendosjeve, transportit dhe funksionimit jashtë kushteve teknike.
12. Elementet e përfshira në garancinë e prodhuesit.

Dispozitat

- | | |
|----------------------------------|---|
| Memo 1 – Shuma e Siguruar | Do të jetë kërkesë e kësaj Police që shumën e siguruar të jetë e barabartë me koston e zëvendësimit të makinerisë së siguruar me një makineri të re të të njëjtit lloj dhe kapacitet, që do të thotë koston e saj të zëvendësimit duke përfshirë psh koston e transportit, detyrimet doganore nëse ka, dhe koston e konstruksionit.
Nëse shumën e siguruar është më pak se shumën që kërkohej të sigurohet, Siguruesit do të paguajnë proporcionalisht me % që shumën e sigurimit ze në shumën totale për të siguruar. Çdo artikull, nëse ka më shumë se një të tillë, do të jetë subjekt i këtij kushti veçmas. |
| Memo 2
Bazat e dëmshpërblimit | a Në rastet kur dëmi ndaj artikullit të siguruar mund të riparohet – Siguruesi do të paguajë shpenzimet e nevojshme që kërkohej për të restauruar makinerinë e dëmtuar në gjendjen e saj të mëparshme të shërbimit plus koston e çmontimit dhe rindërtimit që duhen për qëllime të ndikimit të riparimeve gjithashtu edhe pagesën e transportit deri tek dhe nga vendi i riparimit, tarifën dhe detyrimet doganore, nëse ka, në masën që shpenzime të tilla janë përfshirë në shumën e siguruar. Nëse riparimet kryhen në një laborator që është në pronësi të të Siguruarit, Siguruesit koston e materialeve dhe pagat që janë shkaktuar për qëllimet e riparimit plus një përqindje të arsyeshme për të mbuluar detyrimet e ngarkuara.
Asnjë zbritje nuk do të bëhet për zhvlerësimin përse i përket pjesëve të zëvendësuesve, por vlera e çdo prone të shpëtuar do të merret në konsideratë.
Nëse kostoja e riparimit siç është dhënë e hollësishme këtu poshtë është e barabartë dhe kalon vlerën aktuale të makinerisë së siguruar menjëherë përpara ndodhisë së dëmit, artikulli do të njihet si i shkatërruar dhe vendosja e tij do të bëhet në bazë të bazës së parashikuar në pikën 2 më poshtë.
b Në rastet kur një artikull i siguruar është shkatërruar – Siguruesit do të paguajnë vlerën aktuale të artikullit menjëherë përpara ndodhisë së humbjes, duke përfshirë detyrimet për transportimin, koston e konstruksionit, dhe detyrimet doganore, nëse ka, me kusht që këto shpenzime të jenë të përfshira në shumën e siguruar, një vlerë e tillë aktuale që do të llogaritet duke zbritur zhvlerësimin e duhur nga vlera e zëvendësimit të artikullit.
Siguruesit do të paguajnë gjithashtu çdo pagesë normale për çmontimin e |

makinerive të dëmtuara, por rekuperimi (shpëtimi i pronës) do të merret në konsideratë.

Çdo pagesë shtesë e ardhur si rezultat i punës jashtë orarit, orëve të natës, punës gjatë pushimeve publike, dhe çdo shpenzim transporti do të mbulohet nga kjo Policë vetëm nëse është rënë dakort veçmas me shkrim.

Kostoja e ndryshimeve, shtesave, përmirësimeve apo riparimeve kapitale nuk do të jetë e rekuperueshme sipas kësaj Police.

Kostoja e çdo riparimi do të mbulohet nga Siguruesit nëse një riparime të tilla janë pjesë e riparimeve përfundimtare dhe nuk shtojnë koston totale të riparimit. Siguruesit do të kryejnë pagesat vetëm pasi të jenë të kënaqur nga paraqitja e faturave dhe dokumentave të nevojshme që riparimet janë kryer apo zëvendësimet janë bërë, si të jetë rasti.

Kushtet

1 Vëzhgimi i duhur dhe përmbushja e termave të kësaj Police, aq sa ka lidhje me ndonjë gjë që duhet të bëhet apo të përmbushet nga i Siguruari, dhe vertetësia e deklaratave apo përgjigjeve në pyetësonin dhe propozimin e bërë ndaj Siguruesit, do të jetë kusht paraprak për çdo detyrim të Siguruesit.

2 Lista do të konsiderohet të jetë e përfshirë dhe të perbeje një pjesë intergrale të kësaj Police dhe shprehja "kjo Policë", sa herë që përdoret në këtë kontratë, do të lexohet duke përfshirë listën. Çdo fjalë apo shprehje ndaj të cilës një kuptim specifik është bashkangjitur në çdo pjesë të kësaj Police ose të Listës do të ketë një kuptim të tillë kurdo që të shfaqet.

3 I siguruari me shpenzimet e tij do të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të pajtohet me të gjitha rekomandimet e arsyeshme të Siguruesve me qëllim për të parandaluar humbjen apo dëmin dhe për tu pajtuar me kërkesat e statutit dhe rekomandimet e prodhuesve.

4 a Përfaqësuesit e Siguruesit në një kohë të arsyeshme do të kenë të drejtë të inspektojnë dhe ekzaminojnë rrezikun dhe I Siguruari do t'i paraqesë përfaqësuesve të Siguruesve të gjitha hollësitë dhe informacionin e nevojshëm për vlerësimin e riskut.

b I siguruari menjëherë do të njoftojë Siguruesit ose me teleshkrues (telex, telefax, telegram) ose me telefon me shpenzimet e tij duke konfirmuar me shkrim çdo ndryshim material të riskut dhe shkakun që masa të tilla shtesë që do të merren si rrethana mund të kërkojnë sigurimin e një operimi të sigurtë të artikujve të siguruar, dhe qëllimin e mbulimit dhe/ose premiumit, nëse është e nevojshme, të rregullohet siç duhet. Asnjë ndryshim në material nuk do të bëhet apo pranohet nga I Siguruari me anë të të cilit risku rritet, vetëm nëse vazhdimësia e sigurimit konfirmohet me shkrim nga Siguruesit.

5 Në rast se ndodh ndonjë ngjarje e cila mund të shkaktojë ndonjë pretendim sipas kësaj Police, I Siguruari:

a do të njoftojë menjëherë Siguruesit ose me teleshkrues (telex, telefax, telegram) ose me telefon duke konfirmuar me shkrim, duke dhënë një shpjegim për natyrën dhe shtrirjen e humbjes apo dëmtimit;

b të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda fuqisë së tij për të minimizuar masën e humbjes apo dëmit;

c të ruajë pjesët e demtuara dhe t'i bëjë ato të disponueshme për inspektim nga një përfaqësues apo vëzhgues i të Siguruarit;

d të japë këtë informacion dhe prova dokumentare siç mund t'i kërkojnë Siguruesit.

Siguruesit në asnjë rast nuk do të jenë përgjegjës për humbjen apo dëmin për të cilin nuk është marrë asnjë njoftim nga Siguruesit brenda 14 ditëve nga ndodhja e saj. Me marrjen e njoftimit që i është dhënë Siguruesve sipas këtij kushti, I siguruari mund të kryejë riparimet e ndonjë dëmi të vogël ose të

zëvendësojë artikuj që kanë shkaktuar ndonjë dëm të vogël; në të gjitha rastet e tjera një përfaqësues i Siguruesve do të ketë mundësinë të inspektojë humbjen apo dëmin përpara se çdo riparim apo ndryshim të ndikohet. Nëse një përfaqësues i Siguruesve nuk e kryen inspektimin brenda periudhës që konsiderohet e përshtatshme sipas rrethanave, I Siguruari do të ketë të drejtën të vazhdojë me riparimet apo zëvendësimet.

Përgjegjësia e Siguruesve sipas kësaj Police përsa i përket artikullit të siguruar do të ndërpritet nëse artikulli i përmendur pas një kërkesë mbahet në punë pa u riparuar siç dëshirojnë Siguruesit, ose nëse kryhen riparime të përkohshme pa miratimin e Siguruesve.

6 I Siguruari me shpenzimet e Siguruesve do të bëjë dhe do të bie dakort të bëjë dhe të lejojë që të bëhen akte të tilla dhe gjëra që mund të jenë të nevojshme apo të kërkuara nga Siguruesit në interesin e çdo të drejte apo rregullimi, ose duke marrë asistencë apo dëmshpërblim nga palët (të ndryshme nga ato të siguruara në këtë Policë) ndaj të cilëve Siguruesit kanë apo do të kenë të drejtë apo e cila është apo do të jetë detyrim për tu paguar apo përmirësuar si humbje apo dëm sipas kësaj Police, nëse akte të tilla dhe gjëra janë apo bëhen të nevojshme apo të kërkuara përpara apo pas dëmshpërblimit të të Siguruarit nga Siguruesit.

7 Nëse lind ndonjë diferencë në shumën që duhet të paguhet sipas kësaj Police (detyrim duke u pranuar ndryshe), një diferencë e tillë do t'i drejtohet vendimit të një gjykatësi i cili do të emërohet me shkrim nga palët, ose, nëse ata nuk mund të bien dakort për një gjykatës të vetëm, mund të emërohen dy gjykatës, që do të emërohen me shkrim nga secila nga palët, brenda një muaji kalendarik pasi është kërkuar me shkrim një gjë e tillë ose në rast se gjykatësit nuk bien dakort, të emërohet një gjykatës tjetër me shkrim nga gjykatësit përpara se ky i fundit të merret me çështjen. Gjykatësi do të ulet me dy gjykatësit e tjerë që e kanë emëruar dhe do t'i rrijë mbi krye gjatë takimeve. Marrja e një vendimi do të jetë kusht precedent për çdo të drejtë veprimi ndaj Siguruesve.

8 Siguruesit do të kenë të drejtë të mos japin dëmshpërblimin

a nëse ka dyshime përsa i përket të drejtës së të Siguruarit për të marrë dëmshpërblimin, derisa të marrin dëshmitë e nevojshme;

b nëse përveç pretendimit një ekzaminim nga policia apo një kërkesë sipas kodit penal është paraqitur kundër të Siguruarit, në pritje të përfundimit të një ekzaminimi apo kërkesë të tillë.

9 a Nëse propozimi apo deklarata e të Siguruarit është e pavërtetë përsa i përket materialeve, ose nëse ndonjë pretendim i bërë është mashtrim apo i ekzagjeruar ndjeshëm, ose nëse ndonjë deklaram i pavërtetë është bërë në mbështetje të saj, atëherë kjo Policë do të anulohet dhe Siguruesit do të kenë të drejtë të mos bëjnë asnjë pagesë.

b Në rast se Siguruesi mohon përgjegjësinë përsa i përket çdo pretendimi dhe nëse një veprim apo kërkesë nuk është filluar brenda tre muajve pasi është marrë një refuzim i tillë ose (në rastin e gjykimit i cili ndodh në zbatim të Kushtit 7 të kësaj Police) brenda tre muajve pasi gjykatësit dhe gjykatësi i emëruar prej tyre ta kenë marrë vendimin e tyre, i gjithë përfitimi sipas kësaj Police përsa i përket një pretendimi të tillë do të humbasë.

10 Nëse në kohën kur lind ndonjë pretendim, ka ndonjë sigurim tjetër që mbulon të njëjtën humbje apo dëm, Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për të paguar apo kontribuar më shumë se sa pjesa e tyre ndaj çdo pretendimi për një humbje apo dëm të tillë.

11 Kjo Policë nuk mund të përfundohet me kërkesën e të Siguruarit në çdo kohë, rast në të cilin Siguruesi do të mbajë këstin e periudhës së konsumuar për kohën që kjo Policë ka qenë në fuqi. Kjo Policë mund të përfundohet me zgjedhjen e Siguruesve shtatë ditë nga njoftimi që i jepet të Siguruarit, rast në të cilin Siguruesit do të jenë përgjegjës të ripagujnë me kërkesë një këst të premiumit për afatin e pambaruar nga data e anulimit dhe ndonjë pagesë inspektimi që Siguruesi mund të ketë kryer.

12 Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për të paguar interes përveç atij që mund të krijohet për mos permbushje të detyrimeve në kohë.

Shtojca 3 1 3 Mbulimi i zjarrit (te jashtëm /ose te brendshëm), goditjes direkte nga rrufeja, eksplozionit dhe renies së avionëve dhe/ose pjesëve prej tyre

Eshtë rënë dakort dhe pranuar që përveç nënëve përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Police ose të shtuara në të dhe që i Siguruari duhet të paguajë një prim shtesë të përcaktuar, ky sigurim do të zgjerohet me mbulimin e dëmit për shkak të zjarrit, eksplozionit kimik që kanë për origjinë artikullin (ujt) nr. e përmbajtur në specifikimin e Policeve ose për shkak të shuarjes së këtij zjarri ose të goditjes direkte të rrufesë, si dhe të gjitha humbjet e dëmit që nuk kanë për origjinë arikujt e makinerisë e shkaktohen nga shpërndarja e zjarrit ose eksplozionit kimik ose perpjekja për shuarjen e zjarrit.

Shtojca 3 1 2 Mbulimi i makinerive - Rreziqet Natyrore dhe vjedhja

Eshtë rënë dakort dhe pranuar që përveç nënëve, përjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Police ose të shtuara në të dhe që i Siguruari duhet të paguajë një prim shtesë të përcaktuar, Siguruesi do të dëmshperblejë të Siguruarin për dëmin në

Artikullin (ujt) nr. e përmbajtur në specifikimin e Policeve.

Ky dëm është shkaktuar si rezultat i vershimit, termetit, përmytjes, rreshqitjes së tokës ose shkëmbit, fundosjes së dheut dhe vjedhjes me thyerje.

Ky mbulim do të jetë i zbatueshëm për makineritë e pajisjet e siguruara si në rastin kur janë vendosur në një vend ashtu edhe kur ato kanë lëvizur kudo .

I Siguruari do të informojë autoritetet e policisë në rast humbje ose dëmi për shkak të vjedhjes me thyerje

Klauzola e Sanksioneve:

“(Ri)Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë dëm apo të japë ndonjë përfitim të parashikuar në këtë kontratë, në atë masë që sigurimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një dëmi të tillë ose sigurimi i një përfitimi të tillë do ta ekspozojnë (ri)Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi sipas rezolutave të Kombeve të Bashkuara apo sanksioneve tregtare ose ekonomike, legjisllacionit të Bashkimit Evropian, Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës (me kusht që kjo nuk bie në kundërshtim me ndonjë rregullorë ose ligj lokal specifik të zbatueshëm për (ri)siguruesin).”

Klauzola e Përjashtimit të Dëmtimit Kibernetik

Dëmtimi i pronës i mbuluar nga kjo kontratë do të thotë dëmtim fizik i substancës së pronës. Dëmi fizik i substancës së pronës nuk do të përfshijë dëmtimin e të dhënave ose softuerit, në veçanti çdo ndryshim të dëmshëm në të dhënat, softweret apo programet kompjuterike që shkaktohet nga fshirja, korruptimi apo deformimi i strukturës origjinale.

Rrjedhimisht, rastet e mëposhtme janë të përjashtuara nga mbulimi në sigurim:

a) Humbja ose dëmtimi i të dhënave ose i softwerit, në veçanti çdo ndryshim i dëmshëm në të dhënat, softweret dhe programet kompjuterike që shkaktohet nga fshirja, korupsioni ose deformimi i

www.intersig.al